

Në bazë të nenit 55 paragrafi 1 të Ligjit për organizimin dhe punën e organeve në administratën shtetërore („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10, 51/11), dhe Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” 96/19 dhe 110/19) si dhe në bazë të nenit 50 paragrafi 6 të Ligjit për arsim fillor („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 161/2019), ministri i Arsimit dhe Shkencës e përcaktoi programin mësimor të shkurtuar për lëndën mësimore *kimi* për klasën IX (nëntë) në arsimin fillor nëntëvjeçar për vitin shkollor 2020/2021.

## 1. Hyrje

Programi i shkurtuar mësimorë në lëndën e *kimis* për klasën e IX (nëntë) të arsimit fillorë nëntëvjeçar bazohet në qëllimet/ rezultatet e pritura të parashikuara në programin mësimor për lëndën mësimore që realizohet në mënyrë të rregullt në pajtueshmëri me planin e përcaktuar mësimor.

Me programin e shkurtuar mësimor verifikohen tema të caktuara dhe njësi mësimore që duhet të realizohen në 159 ditë mësimore, me çka ruhet fondi javor i orëve të parashikuara me programin e rregullt, gjegjësisht për lëndë mësimore me 2 orë në javë janë paraparë 64 orë me programin e shkurtuar.

Mësimëdhënësi gjatë planifikimit dhe realizimit të njësisë mësimore nga programi i shkurtuar udhëhiqet nga qëllimet/rezultatet e pritura, nocione të caktuara, metoda dhe aktivitete të përcaktuara në programin e rregullt mësimor.

## 2. Pasqyra e temave dhe njësive mësimore

Tema 1. STRUKTURA E ATOMIT DHE SISTEMI PERIODIK I ELEMENTEVE (13 orë)

Njësië mësimore:

- Struktura e atomit
- Struktura e atomit tek njëzet elementet e para
- Simbolet kimike të elementeve
- Konfiguracioni elektronik
- Struktura e Sistemit periodik të elementeve
- Trendet në sistemin periodik të elementeve
- Historia e sistemit periodik të elementeve
- Njohja me lidhjet kovalente
- Formimi i molekulave kovalente

## Tema 2. VALENCA DHE FORMULA (6 orë)

Njësitë Mësimore:

- Përdorimi i valencave për të gjetur formulat molekulare
- Formulatat e komponimeve binare
- Formula të komponimeve që përmbajnë grupe atomike
- Formula të komponimeve që përmbajnë metale kalimtare

## Tema 3. SHPEJTËSIA E REAKSIONIT (10 orë)

Njësitë mësimore:

- Njohja me shpejtësin e reaksionit
- Ndikimi i përqendrimit
- Ndikimi i madhësisë së grimcave
- Ndikimi i temperaturës
- Ndikimi i katalizatorit
- Enzimet janë katalizator biologjik

Tema 4. FORMIMI I LIDHJEVE JONIKE DHE BARAZIMI I EKUACIONEVE KIMIKE (9 orë)

Njësitë mësimore:

- Njohja me nocionin Ion
- Atomet dhe jonet
- Formimi i lidhjes jonike
- Ligji i ruajtjes së masës
- Ushtrime për barazimin e ekuacioneve kimike
- Të shkruarit e ekuacioneve kimike

Tema 5. VARGU I REAKTIVITETIT TE METALEVE (10 orë)

Njësia mësimore:

- Reagimi i metaleve me oksigjenin
- Reagimi i metaleve me ujin
- Reagimi i metaleve me acide
- Përbërja e komponimeve
- Formimi i vargut të reaktivitetit
- Reaksionet e zvendësimit

## Tema 6. PËRFITIMI I KRIPRAVE (7 orë)

Njësitë mësimore:

- Përfitimi i kriprave nga metalet dhe acidet
- Përfitimi i kriprave nga oksidet e metaleve
- Përfitimi i kriprave nga karbonatet
- Përfitimi i kriprave nga hidroksidet

## Tema 7. REAKSIONET EGZOTERME DHE ENDOTERME (9 orë)

Njësitë mësimore:

- Ndryshimet në energji gjatë reaksioneve kimike
- Reaksione egzoterme ose endoterme?
- Djegia –reaksion egzoterm
- Hulumtim i proçeseve endoterme
- Shëndrime fazore endotermike
- Frymëmarja dhe fotosinteza

### 3. Rekomandime didaktike

Në programin e shkurtuar mësimor janë të përfshira përmbajtje mësimore të caktuara të programit të rregullt mësimor të cilat në mes vedi janë në korelacion dhe formojnë një tërësi logjike. Në pjesën *Pasqyra e temave dhe njësit mësimore* janë dhënë tema të cilat janë përcaktuar në programin e shkurtuar mësimor dhe njësitë mësimore që kanë të bëjnë me përpunimin e përmbajtjes së re mësimore.

Për sejcilën temë , është dhënë numri i përgjithshëm i orëve që duhet realizuar. Duke pasur parasysh se renditja e njësive mësimore i referohet zhvillimit të përmbajtjeve të reja mësimore, numri i orëve të mbetur në suaza të temës arsimtari i planifikon, organizon dhe realizon si orë për përsëritje, përforcim, ushtrime, kontrollim të diturive të nxënësive, sistematizim, eksperimente, hulumtim etj. Gjithashtu, një pjesë e këtyre orëve mund të përdoret për realizimin e një përmbajtje të caktuar mësimore gjatë dy orëve mësimore, e cila sipas vlersimit të të mësimdhënsit kërkon një kohë më të gjatë për realizim.

Gjatë mësimdhënies, është e nevojshme të realizohen orë mësimore për ushtrime. Me rëndësi të veçantë është zbatimi i metodës eksperimentale në zhvillimin e përmbajtjes, si dhe përdorimi i ilustrimeve, animacioneve, modeleve dhe të ngjashme.

Gjatë realizimit të mësimdhënies sipas programit të shkurtuar, duhet të merren parasysh drejtimet didaktike, dmth. format, metodat dhe aktivitetet e përcaktuara në programin e regullt mësimor , të cilat u referohen njësive mësimore të përfshirane programin e shkurtuar mësimor.

#### 4. Normativ për kuadrin mësimor

Programin e shkurtuar mësimor e realizon arsimtar në përputhshmëri me normativin për kuadër arsimor i dhënë në programin e regullt mësimor.

Programin e shkurtuar mësimor për lëndën mësimore *kimi* për klasën e IX( nëntë) të arsimit fillor nëntë vjeçar për vitin shkollor 2020/21 emiratoi

Minister,

Mila Carovska